



REPUBLIKA E SHqipërisë

**BASHKIA PATOS**  
**KRYETARI**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më 24/04/2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje zyre dhe informatike për administratën”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**Komputera dektop 30213300-8, Makineri për zyra dhe informatike, pajisje dhe furnizime, përveç mobiljeve dhe paketave software 30000000-9**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1,217,500 (një milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, venë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve.

#### 2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

$$1,217,500 \times 40\% = 487,000$$

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

**2.2.2** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

**Shënim:** *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e*

*aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

$$1,217,500 \times 20\% = 243,500$$

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues,

duke vertetuar nepermjet pervojes se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci për produktet e ofertuara sipas periudhës së garancisë të deklaruar në specifikimet teknike 1 – 3 vite, nga momenti i marrjes në dorëzim, si dhe ndërrimin në raste difektesh nëpërmjet një deklarate për periudhën e garancisë, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë edhe riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale, jetëgjatësi dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

Nisur nga rëndësia që ka objekti i prokurimit për mbarëvajtjen e punës në institucion kërkohet ky kriter për të ofruar siguri autoritetit kontraktor.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër të realizojë furnizimin e mallrave objekt prokurimi (përfshirë kryerjen e shërbimit të transportit të të gjithë artikujve në ambientet e Autoritetit Kontraktor, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambientet e magazinës pranë Bashkisë Patos në datën 07/05/2024 deri në orën 11:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Njësia	Sasia
5	Pajisje për akses kontroll sëbashku me software	SET	1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

**Shënim:** Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat e dorëzuara do të kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit

administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Duke qën se pajisjet janë specifike dhe perdorimi i tyre është shumë profesional është e nevojshme sjella e mostrave për të vërtetuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e pajisjeve me procesin e punës.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesi Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mëposhtëme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Njësia	Sasia
1	Laptop Advanced	Copë	1
3	Kompjuter Desktop 1	Copë	8
5	Pajisje për akses kontroll së bashku me software	SET	1

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 6 b të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky kriter kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

## Specifikime teknike:

## LAPTOP

## ADVANCED

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
<b>Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:</b>	12200 Pikë
<b>“Chipset”:</b>	Intel ose Ekuivalent
<b>“RAM”:</b>	32 GB min. DDR4 2666 MHz
<b>Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:</b>	≥ 500 GB SSD
<b>“Graphics”:</b>	Dedicated Graphics with min. 4 GB Memory
<b>Ekrani “Display”:</b>	≥ 15.6" FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare
<b>Bateria “Battery”:</b>	Min. 60 Wh
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
<b>Portat e Komunikimit “Ports”:</b>	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1 (1) DP/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
<b>Rrjeti “Networking”:</b>	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1;
<b>“Sound”:</b>	Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo)
<b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:</b>	OEM Windows 10 64-bit Professional
<b>Tastiera “Keyboard”:</b>	QWERTY
<b>“Pointing Device”:</b>	Touch Pad
<b>Siguria “Security”:</b>	Embedded Security TPM 2.0
<b>AKSESORËT</b>	
<b>Kabëll “Power Cord”:</b>	Po, European
<b>Ushqyesi “Recharger”:</b>	Po
<b>“Mouse”</b>	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
<b>Çanta “Carrying Bag”:</b>	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
<b>“Recover”:</b>	Recover Partition
<b>GARANCIA</b>	
<b>Periudha e Mbulimit të Garancisë</b>	3 Vjet

<b>“Warranty”:</b>	
--------------------	--

LAPTOP

BASIC

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
<b>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:</b>	4500 Pikë
<b>“Chipset”:</b>	Intel ose Ekuivalent
<b>“RAM”:</b>	16 GB min. DDR4-2133 MHz, Non-ECC
<b>Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:</b>	≥ 256 GB SSD
<b>“Graphics”:</b>	Integrated Graphics with min. 1 GB Video Memory
<b>Ekrani “Display”:</b>	≥ 15.6” LED FHD (1920 x 1080), Anti Glare
<b>Bateria “Battery”:</b>	Min. 45 Wh
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
<b>Portat e Komunikimit “Ports”:</b>	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
<b>Rrjeti “Networking”:</b>	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
<b>“Sound”:</b>	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
<b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:</b>	OEM Windows 10 64-bit Professional
<b>Tastiera “Keyboard”:</b>	QWERTY
<b>“Pointing Device”:</b>	Touch Pad
<b>Siguria “Security Management”:</b>	Embedded Security TPM 2.0
<b>AKSESORËT</b>	
<b>Kabëll “Power Cord”:</b>	Po, European
<b>Ushqyesi “Recharger”:</b>	Po
<b>“Mouse”:</b>	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
<b>Çanta “Carrying Bag”:</b>	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.



<b>“Recover”:</b>	Recover Partition
<b>GARANCIA</b>	
<b>Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:</b>	3 Vjet

## KOMPJUTERA

## DESKTOP 1

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
<b>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:</b>	7900 Pikë
<b>“RAM”:</b>	8 GB min. DDR4-2666 MHz, Non-ECC
<b>Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:</b>	≥ 500 GB SSD
<b>“Disk Subsystem Controller”:</b>	Serial ATA III 6 Gb/s
<b>Karta Grafike “Graphics”:</b>	Integrated graphic Card, min. 1 GB
<b>“Media Device”:</b>	DVD+/-RW
<b>“Slots”:</b>	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
<b>Portat e Komunikimit “Ports”:</b>	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
<b>Rrjeti “Networking”:</b>	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
<b>“Sound”:</b>	Integrated Sound Card
<b>“Speakers”:</b>	Internal or Built-in Monitor
<b>Siguria “Security Management”:</b>	Embedded Security TPM 2.0
<b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:</b>	OEM Windows 10 64-bit Professional
<b>Tastiera “Keyboard”:</b>	Standart Keyboard QWERTY
<b>“Mouse”:</b>	Minimum 3 Button Scroll Optical
<b>Ushqimi “Power Supply”</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:</b>	Energy Star
<b>AKSESORËT</b>	

<b>Kabëll “Power Cord”:</b>	Po, European
<b>“Recover”:</b>	Recover Partition
<b>MONITORI</b>	
<b>Tipi “Type”:</b>	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
<b>Madhësia “Size”:</b>	≥ 21”
<b>Rezolucioni “Native Resolution”:</b>	1920 x 1080 at 60 Hz
<b>Raporti i Kontratit “Constrast Ratio Static”:</b>	1000:1
<b>“Display Port”:</b>	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
<b>Koha e Rifreskimit “Response Time”:</b>	≤ 6 ms
<b>Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:</b>	Energy Star
<b>Ushqimi “Power Supply”:</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>GARANCIA</b>	
<b>Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:</b>	3 Vjet

## SKANER

## TIPI 3

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
<b>Tipi “Type”:</b>	CCD ose CIS ose Ekuivalente
<b>Formati “Format”:</b>	A4
<b>Rezolucioni i Skanimit “Scanning Resolution”:</b>	600 dpi
<b>Mënyra e Skanimit “Scan Mode”:</b>	Simplex dhe Duplex
<b>Vendosja e Materialit “Media Feeder Type”:</b>	ADF
<b>Kapaciteti i ADF “ADF Capacity”:</b>	80 Fletë
<b>Shpejtësia e Skanimit “Scanning Speed”:</b>	45 ppm / 90 ipm (300 dpi)
<b>Ushqimi “Power Supply”:</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>Funksionet “Functions”:</b>	Single and Multi-page, TIFF, JPEG, RTF, PDF, Searchable PDF
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
<b>Porta e Komunikimit “ Interface”:</b>	High-Speed USB 2.0
<b>Kompatibël me Sistemin e Operimit “Compatible O.S.”:</b>	Win. 10 ose më i ri
<b>“Drivers” + OCR Software:</b>	Po

<b>AKSESORËT</b>	
<b>Ushqyes + Kabëll “Power Supply + Cord”:</b>	Po, European
<b>CD/DVD Drivers and Software:</b>	Po
<b>Kabëll për Komunikimin e të Dhënave “Data Cable”:</b>	(1) USB Cable
<b>GARANCIA</b>	
<b>Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:</b>	3 Vjet

Zgjidhja për pajisjen e akses kontrollit duhet të jete e bazuar në TCP/IP në mënyre që ti ofrohet akses të gjithë personave të cilët do të jene të autorizuar për të pare apo për të konfiguruar sistemin.

Specifikime të përgjithshme:

Softweri duhet të jetë i aftë për t’u implementuar për 3 (tre) dyer për të monitoruar hyrje-daljet.

Zgjidhja për softwarin e akses kontrollit duhet të jetë e bazuar në TCP/IP ose RS-485 ose RS-232.

Pajisja i aksesit të kontrollit duhet të përbëhet minimalisht nga elementet:

- Një kontrollor
- 6(gjashte) lexues kartash aksesi.
- 2(dy) kundrabrave elektrike

Kontrolleri duhet të ofrojë të paktën opsione për ndërrim të kartës, shtimin apo heqjen e përdoruesve, etj.

Lexuesi antivandal me IP65;

Te mbeshtesi te pakten teknologjite e kartave Mifare dhe RFID;

Të sinjalizojë mbi gjendjen: Poëer/Status (Red/Green).

Të suportojë:

- Shpejtesia e procesorit: minimalisht 1Ghz.
- Numri i përdoruesve: min. 500;
- Numri i kartave të vlefshme: min. 500;
- Numri i ruajtjes së ngjarjeve: min 10 000 log-e;
- Distanca e leximit të kartes: 1 to 5 cm;
- Temperatura e operimit: -20°C ~ +40°C.

Garanci: 1 vit.

Karta aksesi:

Kartat duhet të jenë kompatibël me sistemin e Aksesit të Kontrollin më sipër.

Të jenë plastike dhe të personalizohen sipas kërkesës.

#### Specifikime të vecanta:

1. Programi i kontrolleve të kohës, paraqitjes dhe qasjes  
Softueri për kohën dhe frekuentimin duhet të jetë një program i avancuar i bazuar në ëeb për kontrollin e kohës dhe frekuentimit, si dhe aksesit. Softueri për kohën dhe pjesëmarrjen të mbajë gjurmët e punës së punonjësve, pagesat e pushimeve, orët jashtë orarit dhe të dhënat e tjera të kohës dhe pjesëmarrjes. Softueri të paraqesë për administratorët një pasqyrë të plotë të kohës kur punonjësit janë duke punuar, kur janë duke marrë pushime, kur janë jashtë të sëmurë, në pushim të lehonisë, pushim studimi, etj. Softueri t'u lejojë punonjësve të kërkojnë pushim. Administratorët të mund të përcaktojnë oraret e tyre, në të cilat punonjësit mund të vijnë ose të largohen nga puna ose thjesht të hyjnë në një vendndodhje të caktuar.

Karakteristikat e softuerit për time attendance.

Softueri i bazuar në web të ketë këto funksione:

- Të kontrollojë linja të shumta komunikimi;
- Të ketë numër të pakufizuar të përdoruesve
- Të ketë suport kontrollues të shumëfishtë aksesi;
- Suporton oraret e shumta për kohën dhe pjesëmarrjen dhe kontrollin e aksesit.
- Grupe të shumta përdoruesish;
- Administratorë të shumtë;
- Mundësia e kufizimit të të drejtave të administratorëve;
- Veprimet të administratorit regjistrohen dhe të mund të raportohen;
- Karakteristika të avancuara, p.sh. kohë të zgjatura të shkyçjes së dyerve për personat me aftësi të kufizuara;
- Informacioni i punonjësve mund të futet drejtpërdrejt ose të importohet;
- Kartat e shumta mund t'i lëshohen çdo përdoruesi;
- Monitorimi i ngjarjeve drejtpërdrejt dhe në kohë reale;
- Emrat e përdoruesve mund të importohen nga skedarët .csv ose Excel;
- Historia e ngjarjeve;
- Raportet dhe filtrimi i ngjarjeve të kaluara;
- Raporte të shumta, p.sh. të drejtat e aksesit dhe aktiviteti i sistemit;
- Regjistrimi i kartelave dhe të dhënave të punonjësve të rinj, rishikimi i të dhënave të orarit të regjistruar dhe frekuentimit, korigjimi i ngjarjeve (hyrje, dalje, drekë, etj.);
- Përgatitja e raporteve dhe ekstrakteve sipas kriterëve të ndryshme, futja dhe ndryshimi i intervaleve kohore etj;
- Të suportojë oraret fikse dhe fleksibël të punës (të mundshme me orar të rrumbullakosur);

- Llogaritja e numrave përkatës të rimbursimeve për drekë dhe makinë për në punë;
- Administratori mund të fusë ngjarjet që mungojnë (ditët e sëmundjes, ditët e pushimit, etj.) dhe të riparojë të dhënat e regjistruara gabimisht (p.sh. punonjësi harron të regjistrojë mbërritjen ose daljen nga puna). Të gjitha të dhënat e korrigjuara manuale janë qartë të dukshme në printimet e raportit në ekran ose printer;
- Punonjësve mund t'u caktohet një fjalëkalim dhe një emër përdoruesi për të parë ngjarjet e tyre të regjistruara dhe për të gjeneruar një raport të ngjarjeve;
- Të ofrojë mundësinë e zgjerimit të funksionalitetit të programit me module dhe aplikacione, si dhe përdorimi nga telefoni (Kamera IP, Layouts, marrja e FrontDesk, etj)
- Softueri të jetë edhe në gjuhën shqipe;

#### Lexuesit

- Lexuesit duhet të suportojnë karte dhe PIN
- Teknologjitë e leximit: Generic 13,56 MHz (MIFARE Classic, MIFARE Plus, vMIFARE DESFire EV1, iCLASS® CSN)
- Shkalla e leximit: 30 mm
- Temperaturat e punës: nga -20 ° C në + 70 ° C
- I pajisur me tamper për të detektuar në qofte se hiqet nga muri.
- Sinjalizimin për: Access Granted, Access Denied, armed, disarmed

Operatori ekonomik përparase të shpallet fitues duhet të paraqesi mostër për këtë zë në preventiv.

#### Grirëse Letre

##### Specifikime te pergjithshme

- Grirëse me opion Micro Cut;
- Të copëtojë: letër,karta krediti etj
- Kapaciteti i koshit jo me i vogël se 20 lt;
- Ngjyra: e zezë/gri e errët;
- Opsion kontrolli on/off
- Niveli i sigurise minumimi P-4
- Kapaciteti grirës min 15 fletë njeherësh
- Garancia jo më pak se 12 muaj.

#### SSD 1TB

1	SSD i brendshëm	1. Ndërfaqja SATA III 2. Të jetë Hard Disk i llojit të brendshëm (Internal Hard Drive). 3. Të jetë modeli i Hard Diskut 2.5” 4. Shpejtësia e Shkrimit $\geq 530$ MB/s 5. Shpejtësia e Leximit $\geq 560$ Mb/s	copë	2
---	-----------------	---	------	---

		6. Të ketë kapacitetin min.1 TB.		
--	--	----------------------------------	--	--

Mjetit crimping RJ45 shërben për:

- Prerjen,
- Zhveshjen e kabëllit
- Shtrëngimin
- Butoni i kyçjes
- Cat5 - Cat7

Ky 3në1 kalon përmes shtrënguesit RJ45 jo vetëm që mund të presë tela, të heq kabllot, por gjithashtu mund të kalojë Crimp RJ45 përmes lidhësve dhe lidhësve të rregullt RJ45; I shpejtë dhe i besueshëm; Ai gjithashtu mund të shtrëngojë lidhësit 6P,8P RJ12, RJ11 I përshtatshëm për kabllot Cat5 Cat5e Cat6 Cat6A Cat7. I lehtë për t'u përdorur.

Mbërthim precizoni dhe material me cilësi premium: Ka performancë të lartë Kalimi përmes Ethernetit është i lehtë për t'u trajtuar, duke lejuar një kapje ergonomike dhe veprim të rehatshëm kompresimi. Doreza është bërë nga materiale të posaçme të rehatshme që nuk rrëshqasin dhe janë të lehta për t'u shtrënguar. Kompleti shtrëngues Ethernet çeliku me material oksid të zi jep performancën, qëndrueshmërinë dhe saktësinë e nevojshme për të kryer punën siç duhet.

**Pajisje për akses kontroll sëbashku me sistemin software PAJISJE PËR MATJEN E ZHURMËS**

- Filtrat e peshimit A dhe C të ndërrueshëm
- Ndërprerës i diapazonit matës të ngadaltë/të shpejtë
- Funksioni MIN/MAX
- Zgjedhjet e diapazonit 30 - 80 dB, 50 - 100 dB, 60 - 110 dB, 80 - 130 dB
- Regjistrimi i të dhënave: 63 grupe të dhënash

**TELEKOMANDA WIRELESS PËR PREZANTIM NË POWER POINT ME LAZER**

Gama e kontrolleve të klikuesit të PowerPoint: 98FT/30M, diapazoni i treguesit lazer: 328FT/100M.

[Marrës USB A & USB C 2 në 1, Vendos dhe Luaj ]

Nuk nevojitet instalim.

Lidhet me marrësin USB në kompjuter dhe fillon përdorimi me treguesin lazer për prezantime. Marrësi i klikuesit rrëshqitës nuk është i përshtatshëm vetëm për pajisjet me ndërfaqe USB A, por edhe për pajisjet me ndërfaqe Type-C.

Klikuesi i prezantuesit me valë me tregues lazer punon me kompjuterë desktop dhe laptop. Telekomanda e prezantimit mbështet sistemet: Windows 2003, XP, Vista, 7, 8, 10, Mac OS,

Linux. Telekomanda e prezantuesit me valë mbështet programet: Google Slides, MS Word, Excel, PowerPoint/PPT, etj.

Klikuesi me valë përdor vetëm dy bateri AAA (të përfshira)

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Informimit Publik pranë institucionit Bashkia Patos në përputhje me objektin e prokurimit dhe nevojat e autoritetit kontraktor, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e çilesisë” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

### **Shënim:**

Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 07.05.2024, ora 11:00.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**